



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura IV

Sesioni pranveror

Komisioni i Shëndetësisë, Punës dhe Mirëqenies Sociale

Mbledhja nr. 34

Prishtinë, më 5 mars 2012, në orën 13: 00

Ndërtesa e Kuvendit, sala N-10

PROCESVERBAL
I MBLEDHJES SË KOMISIONIT PËR SHËNDETËSI, PUNË
DHE MIRËQENIE SOCIALE

Në mbledhje morën pjesë: Fikrim Damka, Salihe Mustafa, Nazane Breca, Time Kadrijaj, Gëzim Kelmendi.

Munguan: Sasha Gjokiq, Liburn Aliu, Flora Brovina.

Të pranishëm: Shpresa Haxhijaj- administratore e Komisionit; Enis Halimi – zyrtar i fushës për shëndetësi; Florie Kryeziu- UNICEF, Mursel Zyberi- ekspert.

Mbledhjen e kryesoi, Fikrim Damka- kryetar i Komisionit.

Në këtë mbledhje u propozua ky

Rend dite:

- 1. Miratimi i rendit të ditës;**
- 2. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e datës 29.02. 2012;**
- 3. Shqyrtimi i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 2003/15 për skemën e ndihmës sociale në Kosovë;**
- 4. Të ndryshme.**

***Kryesuesi** konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës dhe e hapi mbledhjen me shqyrtimin e pikës së parë të rendit të ditës.*

1.Miratimi i rendit të ditës

Rendi i ditës u miratua pa ndryshime.

2. Miratimi i procesverbalit të mbajtur më 29.02. 2012

Kryesuesi konstatoi se Komisioni i Shëndetësisë, Punës dhe Mirëqenies Sociale, pa vërejtje miratoi procesverbalin e datës 29.02.2012.

3. Shqyrtimi i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 2003/15 për skemën e ndihmës sociale në Kosovë

Fikrim Damka- Tha se kemi diskutuar rreth këtij Projektligji në grupin e punës. Ne do të takohemi me përfaqësuesit e UNDP-së dhe përfaqësuesit e FMN-së, më 7 mars në MPMS. Aty do të marrim informatat e nevojshme rreth Projektligjit, sidomos për nenin 4 të tij. Duhet ta procedojmë Projektligjin, duke respektuar afatet ligjore.

Nazane Breca- Deklaroi se jemi dakorduar në grupin e punës që të mos marrim ndonjë vendim rreth neneve të caktuara. Ato do t'i diskutojmë pas takimit që do ta kemi. Ne mund të ndërhyjmë, përveç në Projektligj, edhe në ligj. Me kriteret plotësuese do të mund që numri i përfituesve të ndihmës të mos rritet.

Time Kadriaj- Tha se ne do të shqyrtojmë Projektligjin pa paragjykime dhe apeloj që të ndikojmë te hartuesit e Rregullores së punës që të mos na kufizojnë në të drejtën tonë për të ndërhyrë në ligj. Ne duhet të diskutojmë, përveç për nenin 4, edhe për nenet e tjera.

Salihe Mustafa- Deklaroi se nuk duhet ta kthejmë ligjin. Megjithatë, janë disa gjëra të mira në këtë Ligj. Duhet të punojmë me ekspertin e angazhuar.

Bahri Thaçi- Tha se ka dobësi në secilën komunë rreth këtyre çështjeve. Do të ishte mirë që, pas miratimit të tij, ta mbikëqyrim implementimin e tij. Duhet të angazhohemi që të kemi një shpërndarje të mirave sa më të drejtë për këto kategori. Komisioni mjekësor mund të funksionojë në nivel komunal dhe kjo nuk do të paraqet asnjë implikim buxhetor për punën e këtij Komisioni.

Mursel Zyberi- Tha se ky Ligj nuk do ta prekë buxhetin. Komisionet mjekësore do ta reduktonin numrin e shfrytëzuesve. Komisioni, me qëllim të funksionalizimit më të mirë të punës, do të ishte mirë që t'i përgjigjej komunës. Do të jetë një ligj i mirë për të gjitha shtresat. Neni 4 nuk e rrit numrin e atyre që kërkojnë ndihmën sociale, sepse jo çdo familje me fëmijë nën këtë moshë merr ndihmën sociale. Ka probleme në terren me këtë formë të decentralizimit dhe kjo mundëson keqpërdorim të madh të buxhetit. Arsyeja se pse MPMS-ja ka këtë qëndrim është, sepse MPMS-ja ka numër enorm të punëtorëve dhe komisionet e MPMS-së paguhen secili anëtar me 1200 euro.

Gëzim Kelmendi- Tha se këto çështje do të ishte mirë që të diskutohen në grupin e punës. Ne do të ishte mirë që sot të marrim qëndrim si Komision rreth nenit 4.

Nazane Breca- Tha se problem i madh është centralizimi i punëve dhe, pasi që është kështu, komunat nuk janë fajtores për parregullsi.

Fikrim Damka- Tha se, siç shihet, rreth këtij Projektligji duhet të bëhet punë e madhe, por gjithnjë duhet të kemi kujdes të shtuar për aspektin buxhetor. Grupi i punës duhet të vazhdojë të punojë për shqyrtimin e këtij Projektligji.

E përqatiti:

Njësia për Mbështetjen e Komisionit.

Kryetari i Komisionit

Fikrim Damka